

Fletore Zyrtare nr. 65

Data e publikimit në Fletore Zyrtare: 30.03.2026

VENDIM
Nr. 195, datë 26.3.2026

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË PËRGJITHSHME TË
METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT TË DËNIMEVE ADMINISTRATIVE NË
PROCESIN E INSPEKTIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 44, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullore së përgjithshme të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministritë e linjës, inspektoratet qendrore dhe strukturat inspektuese, Inspektorati i Përgjithshëm, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe inspektoratet vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

**RREGULLORJA E PËRGJITHSHME E METODOLOGJISË SË PËRCAKTIMIT
TË DËNIMEVE ADMINISTRATIVE NË PROCESIN E INSPEKTIMIT**

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Kjo rregullore ka si qëllim përcaktimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e përcaktimit të dënimeve administrative në procesin e inspektimit, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Kjo rregullore është e zbatueshme nga inspektoratet qendrore, inspektoratet vendore dhe strukturat inspektuese, trupat e të cilave gjatë veprimtarisë inspektuese, në rastet e konstatimit të shkeljeve ligjore nga subjektet e inspektimit, japin dënime administrative, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm në fushën përkatëse të inspektimit.

3. Rregullat e përgjithshme të përcaktimit të dënimeve administrative, sipas këtij vendimi, zbatohen në rastet kur në ligjin për inspektimin dhe ligjet e posaçme:

a) dënimet administrative nuk janë të përcaktuara në kryesore dhe plotësuese, me qëllim renditjen sipas një hierarkie të masave administrative;

b) dënimet administrative janë të përcaktuara në intervale, me qëllim përcaktimin e faktorëve të riskut dhe treguesve të shkeljes për çdo rast të mundshëm;

c) përshkallëzimi i dënimit administrativ nuk është i përcaktuar, me qëllim përcaktimin e masës administrative, në varësi të shkeljes ligjore të konstatuar dhe në mënyrë graduale;

ç) shoqërimi i dënimit kryesor me dënime plotësuese nuk është i përcaktuar.

4. Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Dënim administrativ”** ka të njëjtin kuptim si në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

b) **“Faktor”**, një rrethanë, fakt apo ndikim, që përcakton masën e dënimit administrativ;

c) **“Inspektim”**, çdo formë kontrolli sipas përcaktimeve në ligjin nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

ç) **“Inspektim i parë”**, çdo formë kontrolli e ushtruar nga trupa inspektuese, në zbatim të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, që nuk ka për qëllim verifikimin e korrigjimit të shkeljeve të konstatuara më parë dhe që nuk ushtrohet ndaj një subjekti të kualifikuar si “subjekt përsëritës”, sipas këtij vendimi, pavarësisht nëse kryhet sipas programit mujor të inspektimit ose jashtë tij, në përputhje me parashikimet ligjore;

d) **“Paralajmërim”**, dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës inspektuese, sipas përcaktimeve në ligjin për inspektimin;

dh) **“Sistemi elektronik ‘e-Inspektimi’”**, sistemi elektronik unik i inspektimeve, përmes së cilit dokumentohet dhe administrohet veprimtaria e inspektimit, që kryhet nga inspektoratet qendrore dhe vendore, sipas ligjit për inspektimin;

e) **“Sistem pikëzimi”**, mbledhja e vlerës së treguesve për secilin faktor në një shumatore të përgjithshme;

ë) **“Strukturë inspektuese”**, struktura që kryen funksione inspektimi në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore dhe që është në fushë zbatimit të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;

f) **“Subjekt përsëritës”**, subjekti i inspektimit, i cili gjatë ushtrimit të veprimtarisë, në mënyrë të përsëritur më shumë se një herë, konstatohet në kundërshtim apo në shkelje të ligjit në veprimtarinë që kryen, e cila përbën objekt inspektimi, sipas ligjit për inspektimin dhe ligjit të posaçëm për të njëjtën kundërvajtje administrative;

g) **“Tregues i faktorit”**, instrumenti që shërben për përlllogaritjen e vlerës së faktorit.

5. Në përcaktimin e dënimit apo masës administrative, inspektori vendos dënimin administrativ, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të parashikuar nga Kodi i Procedurave Administrative dhe ligji nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, për sa i takon procedurës së inspektimit, si dhe për atë që është e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e qëllimit dhe objektivave të inspektimit, si dhe mospërsëritjen e shkeljes së kërkesave ligjore.

II. METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË DËNIMEVE ADMINISTRATIVE

1. Trupa inspektuese zbaton rregullat dhe procedurat uniforme për vendosjen e sanksioneve administrative, me qëllim që dënimet administrative për shkeljet e kërkesave ligjore të aplikohen në mënyrë të drejtë, të barabartë dhe të qëndrueshme për të gjitha subjektet e inspektimit.

2. Në inspektimin e parë pranë subjektit të inspektimit, trupa inspektuese, kur konstaton shkelje të kërkesave ligjore, për të cilat ligji i posaçëm nuk parashikon pezullimin e aktivitetit, vendos dënimin administrativ “Paralajmërim”, si dhe i lë afat subjektit të inspektimit për korrigjimin e shkeljes së konstatuar.

3. Në inspektimin për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve, kur konstaton se shkeljet e kërkesave ligjore nuk janë korrigjuar nga ana e subjektit të inspektimit, merr dënimin administrativ që të jetë i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e inspektimit, zgjidhjen në kohë të shkeljes, për të arritur përputhshmërinë ligjore e për të penguar përsëritjen e saj në të ardhmen dhe mungesën e bashkëpunimit nga ana e subjektit të inspektuar.

4. Trupa inspektuese, në vendosjen e dënimit administrativ, bazohet në metodologjinë e llogaritjes logjike të të gjithë faktorëve përbërës të tij, për të realizuar zgjidhjen në kohë dhe të drejtë të shkeljes së kërkesave ligjore të konstatuara, sipas parametrave të dënimeve administrative të përcaktuara nga legjislacioni i posaçëm dhe ai i inspektimit, sipas aneksit I.

5. Çdo inspektorat qendror/vendor/strukturë inspektuese në vendimin përfundimtar të inspektimit vendos të gjitha shkeljet ligjore të identifikuara nga legjislacioni i posaçëm dhe dënimet administrative përkatëse, duke bërë lidhjen e shkeljes administrative me dënimin administrativ të parashikuar në këtë legjislacion, nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”.

III. FAKTORËT E RISKUT PËR PËRCAKTIMIN E DËNIMEVE ADMINISTRATIVE

1. Faktorët e riskut për përcaktimin e dënimit administrativ vlerësojnë shkallën e shkeljes dhe ndikimin e saj, me qëllim përcaktimin e masës së dënimit, në përputhje me parimin e

proporcionalitetit dhe transparencës, për reflektimin me saktësi rrezikshmërinë dhe ndikimin e shkeljes.

2. Faktorët e riskut për përcaktimin e dënimit administrativ kontribuojnë në vlerësimin e çdo shkeljeje, sipas rrethanave konkrete dhe karakteristikave të subjektit, me qëllim individualizimin e çdo shkeljeje administrative.

3. Në përzgjedhjen e dënimit administrativ dhe caktimin e masës së tij, trupa inspektuese merr parasysh përmbajtjen e faktorëve, si më poshtë vijon:

a) Rrethanat në të cilat është konstatuar shkelja, në bazë të elementeve faktike të evidentuara gjatë procesit të inspektimit dhe dokumentacionit përkatës;

b) Natyra, rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes së kërkesës ligjore, duke marrë parasysh natyrën, objektin ose qëllimin e veprimtarisë së subjektit të inspektimit;

c) Pasojat e konstatuara të shkeljes në raport me interesin publik dhe me të drejtat e ligjshme të personave fizikë ose juridikë, për aq sa këto pasoja janë të verifikueshme gjatë procesit të inspektimit;

ç) Çdo veprim që subjekti i inspektimit ka ndërmarrë për të zbutur dëmin e shkaktuar, si rezultat i shkeljes së kryer;

d) Shkalla e përgjegjësisë së subjektit të inspektimit, duke marrë parasysh masat e zbatuara prej tij, për të garantuar zbatimin e ligjit;

dh) Historiku i shkeljeve të konstatuara nga inspektimet e mëparshme, veçanërisht kur ato janë të ngjashme me shkeljet në shqyrtim apo kur subjekti është përsëritës;

e) Bashkëpunimi me institucionin përkatës për të eliminuar apo për të zgjidhur problemet në kohë;

ë) Zbatimi i masave për korrigjimin e shkeljeve, kur përpara shkeljes për të cilën jepet dënimi administrativ, këto masa janë dhënë ndaj subjektit në lidhje me të njëjtën shkelje ose shkelje të ngjashme;

f) Zbatimi i afatit të arsyeshëm të korrigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave, që rrjedhin prej tyre, për aq sa nuk vjen me kundërshtim me përcaktimet e ligjit të posaçëm për afatet administrative të rikthimit të gjendjes së ligjshmërisë nga subjekti i inspektimit;

g) Madhësia e subjektit të inspektimit dhe vëllimi i punës që kryen;

gj) Eksperienca/vjetërsia në zhvillimin e veprimtarisë të subjektit të inspektimit, si rrethanë lehtësuese ose rënduese, në varësi të rastit konkret;

h) Çdo rrethanë tjetër rënduese ose lehtësuese, që lidhet me rrethanat e çështjes së inspektimit, si përfitimet financiare ose humbjet e shmangura, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga shkelja e konstatuar.

4. Për secilin nga faktorët e parashikuar në pikën 3, të këtij kreu, inspektoratet qendrore, inspektoratet vendore dhe strukturat inspektuese përcaktojnë treguesit dhe kufijtë minimalë dhe maksimalë të secilit prej tyre, për aq sa nuk vijnë në kundërshtim me ligjin e posaçëm.

IV. IDENTIFIKIMI DHE VLERËSIMI I FAKTORËVE

1. Trupa inspektuese, gjatë procesit të inspektimit, identifikon gjendjen e treguesve të faktorëve, që përcaktojnë masën e dënimit, rast pas rasti, lidhur me situatat ose rrethanat e shkeljes së kërkesave ligjore të konstatuara, llojin dhe peshën e shkeljes.

2. Gjatë procesit të inspektimit, pas identifikimit të shkeljes, trupa inspektuese realizon vlerësimin e faktorëve, duke renditur faktorët në përputhje me rëndësinë e tyre në rastin, objekt inspektimi, si dhe duke analizuar ndikimin e çdo faktori.

3. Përlllogaritja e shumatores së përgjithshme, duke përcaktuar vlerën e treguesit për çdo shkelje, kryhet nëpërmjet sistemit elektronik të inspektimeve “e-Inspektimi”.

4. Vendosja e dënimit administrativ, me masë administrative “gjobë”, bëhet në modulën përkatës për vjeljen e gjobave.

5. Në përcaktimin e faktorëve, inspektorati qendror, inspektorati vendor dhe struktura inspektuese, sipas fushës së përgjegjësisë, vendos treguesit për secilin faktor dhe vlerësimin

përkatës për çdo njërin prej tyre. Këta tregues mund të ndryshojnë sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

V. TREGUESIT E FAKTORËVE QË PËRCAKTOJNË MASËN E DËNIMIT ADMINISTRATIV

1. Faktorët e shkeljes/kundërvajtjes administrative janë rrethanat që përcaktojnë dhe ndikojnë në masën e dënimit administrativ.

2. Treguesit e faktorëve që përcaktojnë dënimin administrativ janë komponentë të veçantë në përcaktimin e saktë të sanksioneve për shkeljet administrative të konstatuara.

3. Treguesit e faktorëve të shkeljes/kundërvajtjes shprehin në mënyrë cilësore dhe sasiore peshën e tyre brenda të njëjtit faktor, si dhe ndërmjet faktorëve të ndryshëm të shkeljes/kundërvajtjes.

4. Treguesit e faktorëve të shkeljes/kundërvajtjes janë të matshëm në një shumatore të përgjithshme për të gjithë faktorët e dënimit administrativ.

5. Peshat e treguesve të faktorëve të shkeljes/kundërvajtjes përditësohet në bazë të kriterëve objektive të inspektorateve qendrore, inspektorateve vendore dhe strukturave inspektuese.

6. Inspektoratet qendrore, inspektoratet vendore dhe strukturat inspektuese përcaktojnë në rregulloren e tyre të metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative, në fushën e tyre të inspektimit, pikët konkrete për secilin nga treguesit e faktorëve, brenda kufijve të caktuar për respektimin e kërkesës ligjore, duke marrë si standard praktikat më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare.

VI. SISTEMI I PIKËZIMIT

1. Klasifikimi dhe sistematizimi i faktorëve të përcaktuar për secilin inspektorat qendror, inspektorat vendor apo strukturë inspektuese realizohet nëpërmjet llogaritjes së shumës së pikëve për të gjithë treguesit dhe siguron proporcionalitetin në përcaktimin e masës së dënimit administrativ.

2. Matja e ndikimit të faktorëve në vlerën e dënimit realizohet nëpërmjet bashkimit të shumës së secilit faktor, sipas pikës 1, të këtij kreu.

3. Shkalla e pikëzimit përcakton vlerën e masës administrative në intervalin e dënimit administrativ, që parashikohen në legjislacionin e posaçëm për çdo shkelje të kërkesave ligjore.

4. Sistemi i pikëzimit lidh kategoritë e shkeljeve me faktorët e vlerësimit, ku dënimi administrativ i përshtatshëm përcaktohet nga shuma totale pikëve të grumbulluara.

VII. IMPLEMENTIMI I METODOLOGJISË SË DËNIMIT ADMINISTRATIV NË SISTEMIN ELEKTRONIK TË INSPEKTIMEVE

1. Pikëzimi për vlerësimin e dënimit administrativ integrohet në sistemin elektronik të inspektimit “e-Inspektimi”, sipas metodologjisë së përcaktimit të dënimeve administrative në këtë sistem, si dhe specifikave për çdo inspektorat qendror, inspektorat vendor apo strukturë inspektuese.

2. Vendimi përfundimtar i inspektimit merret pas përcaktimit të masës së dënimit administrativ, bazuar në sistemin e pikëzimit, sipas tabelës së pikëzimit të faktorëve të vlerësuar.

3. Vendimi përfundimtar i inspektimit shoqërohet nga dokumenti i matricës që gjeneron sistemi për dënimin administrativ, sipas aneksit I.

VIII. KLASIFIKIMI I DËNIMEVE ADMINISTRATIVE

1. Shkelja e kërkesave ligjore, që konstatohet nga trupa inspektuese gjatë kryerjes së procedurës inspektuese, kur nuk përbën kundërvajtje penale, përbën kundërvajtje administrative, për të cilën vendoset dënimi administrativ përkatës për arritjen e qëllimit të inspektimit.

2. Dënimet administrative, sipas ligjit për inspektimin, klasifikohen në dënime administrative kryesore dhe dënime administrative plotësuese.

3. Dënimi administrativ kryesor mund të jepet bashkë me dënime plotësuese, sipas përcaktimit në ligjin e posaçëm.

4. Për të njëjtën shkelje mund të vendoset një dënim administrativ kryesor dhe një apo më shumë dënime plotësuese.

5. Dënime administrative kryesore janë:
- a) paralajmërimi;
 - b) masa administrative “gjobë”;
 - c) masa administrative “gjobë” për moskorrigjimin e shkeljes së kërkesës ligjore, sipas ligjit për inspektimin;
 - ç) pezullimi aktivitetit;
 - d) shfuqizimi i lejes, licencës ose autorizimit të përcaktuar si dënim kryesor në ligjin e posaçëm;
 - dh) prishja e objektit, të rezultuar me shkelje të kërkesave ligjore;
 - e) çdo masë tjetër e kësaj kategorie, e parashikuar në ligjin e posaçëm.
6. Dënime administrative plotësuese janë:
- a) masa administrative “gjobë”, e përcaktuar si dënim plotësues në ligjin e posaçëm;
 - b) pezullimi i aktivitetit, i përcaktuar si dënim plotësues në ligjin e posaçëm;
 - c) shfuqizimi i lejes, licencës ose autorizimit, e përcaktuar si dënim plotësues në ligjin e posaçëm;
 - ç) çdo masë tjetër administrative e barasvlershme me to, sipas ligjit të posaçëm.
7. Paralajmërimi është dënim administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit dhe në të gjitha rastet kur konstatohen shkelje të kërkesave ligjore, që përbëjnë kundërvajtje administrative. Inspektoratet, të cilat në përputhje me ligjin e posaçëm, në inspektimin e parë zbatojnë vetëm këshillimin, nuk vendosin dënim administrativ “paralajmërim”, sipas përcaktimit të kësaj pike.
8. Dënim administrativ kryesor me paralajmërim nuk zbatohet në rastet e shkeljeve të rënda, për të cilat parashikohet masa e pezullimit të aktivitetit, sipas ligjit të posaçëm.
9. Dënim administrativ kryesor “paralajmërim” merret nga trupa inspektuese edhe kur konstaton shkelje të kërkesave ligjore, që përbën kundërvajtje administrative, por që pasoja e ardhur është e vogël, apo për të cilën ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës administrativ.
10. Dënim administrativ kryesor me paralajmërim shoqërohet me urdhërimin e subjektit për të korrigjuar shkeljet e konstatuara dhe për të eliminuar pasojat e tyre, duke përcaktuar edhe një afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi përfshin edhe këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve.
11. Çdo inspektorat qendror, inspektorat vendor dhe strukturë inspektuese harton rregulloren e metodologjisë së përcaktimit të dënimeve në fushën e tij të inspektimit, ku përcakton në mënyrë specifike dhe sipas sistemit të pikëzimit të gjitha shkeljet e kërkesave ligjore, si dhe ato me rëndësi të vogël, që përbëjnë kundërvajtje administrative ose për të cilat ligji i posaçëm nuk parashikon dënim administrativ, për të cilat subjekti dënohet me “paralajmërim”.
12. Kjo rregullore i paraqitet për dhënie mendimi inspektorit të Përgjithshëm, i cili ia dërgon për miratim ministrit përgjegjës për inspektoratet qendrore dhe kryetarit të bashkisë për inspektoratet vendore.

IX. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen inspektoratet qendrore, inspektoratet vendore dhe strukturat e tjera inspektuese të hartojnë dhe të miratojnë rregulloret e tyre, sipas metodologjisë së përgjithshme të përcaktimit të dënimeve administrative, në fushën e tyre të inspektimit, sipas parashikimeve të pikës 8, të nenit 44, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën Shqipërisë”.

ANEKS I CAKTIMI I DËNIMIT ADMINISTRATIV

Nr. III/00000007/VP, datë _____.____._____

(Emërtimi i inspektoratit)

(Në rast të drejtorive rajonale – Drejtoria Rajonale)

Emri i subjektit (kjo pjesë plotësohet nga sistemi)

Në zbatim të nenit 43, të ligjit nr. 99/2024, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, dhe ligjit të posaçëm,

Shpjegimi i fakteve që janë bërë shkak për vendosje të dënimit administrativ:

FAKTORËT E DËNIMIT ADMINISTRATIV

Nr.	FAKTORËT	PIKËT
1	Qëllimi, nëse shkelja është kryer me dashje ose nga pakujdesia	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
2	Natyra, rëndësia dhe kohëzgjatja e shkeljes, duke marrë parasysh natyrën, objektin ose qëllimin e veprimtarisë së subjektit	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
3	Dëmin e shkaktuar ndaj interesit publik dhe të interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridikë, numrin e personave të tretë të dëmtuar, nëse ka, si dhe nivelin e dëmit të shkaktuar ndaj tyre	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
4	Çdo veprim që subjekti ka ndërmarrë për të zbutur dëmin e shkaktuar	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
5	Shkalla e përgjegjësisë së subjektit, duke marrë parasysh masat e zbatuara prej tij për të garantuar zbatimin e ligjit	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
6	Historiku i shkeljeve, veçanërisht kur ato janë të ngjashme me shkeljet në shqyrtim	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
7	Bashkëpunimi me inspektoratin qendror përkatës për të eliminuar apo zgjidhur problemet në kohë	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
8	Zbatimi i masave për korrigjimin e shkeljeve, kur përpara shkeljes për të cilën jepet dënimi administrativ, këto masa janë dhënë ndaj subjektit në lidhje me të njëjtën shkelje ose shkelje të ngjashme	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	

	Treguesi n...	
9	Zbatimi i afatit të korigjimit të shkeljeve të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
10	Madhësia e subjektit të inspektimit dhe vëllimi i punës që kryen	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
11	Eksperiencia/vjetërsia në punë e subjektit të inspektimit	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
12	Çdo rrethanë tjetër rënduese ose lehtësuese që lidhet me rrethanat e çështjes, si përfitimet financiare ose humbjet e shmangura, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga shkelja	
	Treguesi 1...	
	Treguesi 2...	
	Treguesi n...	
Totali i pikëve		

Shembull praktik i caktimit të dënimit administrativ

Totali i pikëve është 100 pikë

Intervali i dënimit administrativ: 100 000–500 000

- a) deri në 20 pikë caktohet dënimi administrativ 100 000 10%;
- b) 21 deri 30 pikë caktohet dënimi administrativ 200 000 30%;
- c) 31 deri 40 pikë caktohet dënimi administrativ 300 000 50%;
- ç) 41 deri 50 pikë caktohet dënimi administrativ 400 000 70%;
- d) Mbi 50 pikë caktohet dënimi administrativ 500 000 100%.

Shënim. Pikëzimi përcaktohet sipas metodologjisë përkatëse të secilit inspektorat/strukturë inspektuese.